



THE EUROPEAN UNION'S CROSS BORDER
COOPERATION PROGRAM

IPA CBC funded project under Europe Aid/170339/DD/ACT/MK

Project: CROSS BORDER FIRESHIELD

Cërrik 05.04.2024

Në kuadër të projektit Fireshield, Caritasi i Shqipërisë së Jugut, ka dorëzuar prane ambienteve të sektorit të Zjarrfikëses në Cërrik, dhjetë sete të cilat përfshijnë mjete që do të përdoren nga sistemi i vullnetarëv pranë këtij sektori, për parandalimin e zjarreve në kullota e pyje.

Ky aktivitet, vjen si një hallkë tjetër përforcuese e sistemit të mbrojtjes nga zjarret për këtë bashki, i cili është një nga objektivat kryesore të këtij projekti. Për këtë arsye për realizimin e tij, Caritasi i Shqipërisë së jugut, ka kërkuar bashkëpunimin e të gjithë aktorëve, përfshirë Bashkinë Cërrik dhe Sektorin Zjarrfikës pranë së njëjtës Bashki.

Përfaqësues të këtij sektori shprehën falenderime për dhurimin e këtyre seteve, duke i vlerësuar ato si një domosdoshmëri për rritjen e efektivitetit dhe cilësisë e punës së këtij sektori, për t'i ardhur në ndihmë sa me shpejt cdo situatë emergjente të komunitetit tonë.

Partnerët, në këtë rast, rinovuan edhe njëherë angazhimin për realizimin e aktiviteteve të radhës që janë ato të trajnimve të grupit të vullnetarëve dhe atë të fushatës së ndërgjegjësimit për banorët për sa i përket parandalimit të zjarreve.

Ky aktivitet zbatohet në kuadër të projektit CROSS – BORDER FIRESHIELD i financuar në kuadër të thirrjes IPA II, CBC, Europe Aid/170339/DD/ACT/MK.

Implemented by:




Caritasi i Shqipërisë së Jugut
Cërrik - Ferme



THE EUROPEAN UNION'S CROSS BORDER
COOPERATION PROGRAM



Implemented by:



Caritasi i Shqipërisë së Jugut
Cerrik - Ferme